



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K2/M15-10 Prot.**  
**Nr. Dok. 202500474/9**

**Tiranë 23/10/2025**

**Lënda:** *Marrjen e masave për garantimin e përkthyesit në procesin penal.*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
**Tiranë**

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**  
**Tiranë**

**Për dijeni: GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT**  
**TË PËRGJITHSHËM VLORE**

*Të nderuar,*

Në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e shtetasës së paraburgosur rumune, M.C, për zvarritje të procesit gjyqësor penal, për shkak të mosparaqitjes së përkthyesit të gjuhës rumune në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

**I. Rrethanat e çështjes**

Sipas pretendimeve të paraqitura nga shtetasja e huaj, në datën 25.01.2024 ishte caktuar seanca paraprake e cila nuk u mbajt, për shkak të mungesës së përkthyesit shqip-

rumanisht. Kështu, edhe në vijim seancat gjyqësore janë shtyrë, për të njëjtën arsye, mungesës së përkthyesit.

Duke vlerësuar se zvarritjet për të caktuar një përkthyes për shtetasit e huaj në procesin penal, janë në shkelje të të drejtave për një proces të rregullt ligjor, kemi kërkuar informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Me shkresën nr.351/1 prot., datë 08.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, janë vënë në dispozicion kopje të akteve gjyqësore që i përkasin çështjes nr.545 akti, datë regjistrimi nr.19.07.2024 me të pandehur M.C dhe të tjerë shtetas rumunë. Kjo çështje fillimisht ka qenë në gjykim pranë gjyqtarës Lirëza Sinollari dhe pas largimit të kësaj të fundit me leje barrë lindje, çështja penale e sipërcituar në bazë të urdhrit nr.207 prot., datë 23.04.2024 është rishortuar dhe i ka kaluar për gjykim gjyqtarës Mirela Mishgjoni.

Rezulton se me vendimin e ndërmjetëm të datës 15.12.2023, gjyqtare Lirëza Sinollari ka caktuar datën e seancës paraprake, duke përcaktuar shprehimisht në vendim njoftimin e përkthyesit Edison Beta me fletëthirrje. Në procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara, janë pasqyruar rastet e mosparaqitjes së përkthyesit, duke pasqyruar shtyrjen e seancës.

Pas informacionit të kërkuar në Ministrinë e Drejtësisë, me shkresën nr.M-304/1 prot., datë 10.10.2024 na bën me dije se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr.1267, datë 18.03.2024 me anën e postës elektronike të datës 18.03.2024 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë urgjente për caktimin e një përkthyesi të gjuhës rumune në kuadrin e çështjes penale nr.1267, ku ndër të tjerë është e pandehur edhe znj.M.C, pasi përkthyesit zyrtarë të gjuhës rumune nuk kanë pranuar, për shkak të pagesës së ulët.

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet postës elektronike të datës 19.03.2024 i ka kthyer përgjigje gjykatës së mësipërme, duke i vënë në dispozicion listën e përkthyesve zyrtarë të gjuhës rumune me numrat e kontaktit dhe duke informuar se kjo ministri ka kompetencë kryerjen e provimit të kualifikimit dhe publikimin e listës së përkthyesve zyrtarë. Çdo institucion kushtetues, publik, privat ka të drejtën e thirrjes së ekspertit, përfshirë dhe

përkthyesin zyrtar. Ministria e Drejtësisë nuk ka kompetenca për detyrimin e përkthyesit zyrtar për të ofruar shërbimin e përkthimit.

Gjithashtu, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i ka drejtuar një kërkesë për caktim përkthyesi dhe Ambasadës së Rumanisë në Tiranë. Me shkresën nr.5809/2 prot., datë 18.04.2024, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka përcjellë notën e Ambasadës së Rumanisë në Tiranë me nr.553 prot., datë 11.04.2024 drejtuar kësaj ministrie ku ndër të tjera theksohet se është përgjegjësi e Republikës së Shqipërisë të garantojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Me shkresat nr.2192 prot., datë 21.04.2024 dhe 23.04.2024 Ministria e Drejtësisë i ka kthyer përgjigje Ambasadës së Rumanisë në Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë se është detyrim i shtetit shqiptar sigurimi i përkthyesit.

VKM nr.407, datë 05.07.2023 përcakton rregullat dhe kriteret e përzgjedhjes, kontraktimit dhe shpërblimit të përkthyesve zyrtarë nga çdo organ kontraktues të cilit ligji i ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar në Republikën e Shqipërisë. Në këtë vendim dhe në ligjin nr.82/2021 *“Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”* parashikohet gjithashtu mënyra dhe hapat e mëtejshëm në rast refuzimi, pa arsye ligjore nga ana e përkthyesve zyrtarë.

Përcaktimi i tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar parashikohet nga Udhëzimi i përbashkët nr.8, datë 19.07.2022<sup>1</sup>, si dhe pika IV e Udhëzimit nr.4, datë 12.12.2012<sup>2</sup> për sa i përket pagesës së shpenzimeve ditore kur ata thirren nga gjykatat.

Nga dokumentacioni i administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë konstatohet se gjyqtarja Lirëza Sinollari ditën që ka caktuar seancën paraprake të datës 25.01.2024 ka theksuar të njoftohen për datën dhe orën e gjykimit nga sekretaria gjyqësore prokuroria, të pandehurit dhe përkthyesi.

---

<sup>1</sup> Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 19.07.2022 *“Për përcaktimin e tarifave dhe për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfutues të ndihmës juridike”*.

<sup>2</sup> Udhëzim nr.4, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave *“Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*

Pavarësisht se nga gjyqtaret janë caktuar rregullisht seancat gjyqësore, konstatohet se 9 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së përkthyesit të gjuhës rumune (konkretisht 04.03.2024; 13.03.2024; 08.04.2024; 23.04.2024; 03.06.2024; 18.06.2024; 26.06.2024; 10.07.2024; 18.09.2024).

Mosparaqitja e përkthyesit pa shkaqe të arsyeshme, ka bërë që procesi të shtyhet dhe gjithashtu të zvarritet çështja penale për disa muaj rresht. Nga ana e tyre, gjyqtaret përveç caktimit të përkthyesve zyrtarë të ndryshëm, i janë adresuar edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ambasadës rumune.

Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht procesi gjyqësor është mbyllur.

## **II. Vlerësimi ligjor dhe procedural**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Në nenin 16 të saj parashikohet se të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

Shtetasve të huaj ligji themelor iu njeh shprehimisht të drejtat e tyre na rast të heqjes së lirisë. Kështu, sipas nenit 28 të Kushtetutës *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim*

*të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.”*

Garancitë e njohura dhe sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë janë njëkohësisht pjesë e Kodit të Procedurës Penale, për të mundësuar realizimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit penal.

Në nisje të tij Kodi i Procedurës Penale, pikërisht në nenin 8 përcakton se në të gjitha fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip përdorin **gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit**, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit. Personat që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin kanë të drejtë të përdorin gjuhën e shenjave. **Shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit paguhën nga shteti.**

Pra, caktimi i një përkthyesi është kusht për realizimin e një procesi të rregullt ligjor. Fryma e përgjithshme e kodit është në përputhje të ngushtë me këtë parim. Duke filluar nga neni 8 e në vijim me nenet 31, 34, 98, 128.

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) **të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;**
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
- d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Në nenin 34/a të Kodit të Procedurës Penale parashikohen të drejtat e të pandehurit ose personit nën hetim si vijon:

1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë:

- a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;
- b) **të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;**

Në përputhje me nenin 98 të Kodit të Procedurës Penale gjuha e akteve procedurale bëhet në gjuhën shqipe. Personi që nuk flet gjuhën shqipe pyetet në gjuhën amtare ose në një gjuhë tjetër që kupton, të zgjedhur prej tij. Procesverbali mbahet në gjuhën shqipe.

Shkelja e këtyre rregullave sjell pavlefshmërinë e aktit.

Ndërkohë, neni 123 i Kodit të Procedurës Penale parashikon procedurën e caktimit të një përkthyesi në procesin penal.

1. I pandehuri që nuk njeh gjuhën shqipe ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes për të kuptuar akuzën dhe për të ndjekur veprimet ku merr pjesë. Nëpërmjet përkthyesit ai është i detyruar të bëjë një deklaratë me shkrim që nuk e njeh gjuhën shqipe. Kur i pandehuri deklaron se e njeh gjuhën shqipe, mund të heqë dorë nga kjo e drejtë.
2. **Autoriteti procedues cakton, gjithashtu, një përkthyes kur duhet të përkthehet një shkrim në gjuhë të huaj.**
3. **Përkthyesi caktohet edhe kur gjykata, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore e njohin gjuhën që duhet të përkthehet.**
4. Dispozitat për caktimin e përkthyesit për të pandehurin zbatohen edhe për viktimën.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e njeh dhe e garanton këtë të drejtë, në kuadër të procesit të rregullt ligjor neni 6 i saj.

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e

nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

**e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.**

Në jurisprudencën kushtetuese, referuar edhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e drejta e individit palë e një gjykimi për t'u informuar në gjuhën që kupton është vlerësuar në funksion të së drejtës së mbrojtjes<sup>3</sup>.

Gjykata thekson se, e drejta e individit, palë e një gjykimi, për të pasur ndihmën e një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe (neni 31/c i Kushtetutës), është një parakusht i respektimit të të drejtës për t'u dëgjuar para se të gjykohet, (neni 33 i Kushtetutës), i cili është një nga garancitë themelore për realizmin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata vlerëson gjithashtu, se e drejta për të pasur ndihmën e një përkthyesi, kur nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën shqipe, edhe pse në mënyrë të shprehur është sanksionuar si një e drejtë e të akuzuarit në një proces penal, (neni 31/a i Kushtetutës dhe neni 6/3/a i KEDNJ-së), kjo e drejtë përfshin edhe procesin e gjyimit të të drejtave civile. Gjykata, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, vëren se, e drejta e individit palë e një

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. 35, datë 25.07.2011 i Gjykatës Kushtetuese

gjykimi, për t'u informuar në gjuhën që kupton, është vlerësuar në funksion të së drejtës së mbrojtjes.

Përveç sa më lart paragrafi 3, shkronja “e”, i nenit 6 të KEDNJ-së parashikon se çdo person i akuzuar ka të drejtën e ndihmës falas të një përkthyesi. **Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së kjo e drejtë zbatohet jo vetëm për deklaratat me gojë të bëra në seancën gjyqësore, por edhe për dokumentet dhe procedurat paragjyqësore**<sup>4</sup>. Për sa i përket fazës paraprake, Gjykata vëren se ndihma e një përkthyesi, si ajo e një avokati, duhet të ofrohet që në fazën e hetimit, përveç rasteve kur tregohet se ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë<sup>5</sup>.

Në lidhje me të drejtën e të pandehurit për t'u njohur me akuzën dhe aktet në një gjuhë që ai kupton GJEDNJ-ja ka theksuar se është detyrë e autoriteteve vendase që të verifikojnë nëse i pandehuri kupton gjuhën e gjykatës ose gjuhën e akteve<sup>6</sup>.

Sipas GJEDNJ-së, konventa u lë shteteve anëtare hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me zgjedhjen e mjeteve për të siguruar që sistemi ligjor i brendshëm të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6 dhe se nuk i takon asaj gjykate të përcaktojë masat konkrete që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase për të verifikuar njohuritë gjuhësore të një të pandehuri që nuk është mjaftueshëm i aftë të njohë gjuhën në të cilën zhvillohen procedurat. Në varësi të faktorëve të ndryshëm, siç është natyra e veprës penale dhe komunikimet që i drejtohen të pandehurit nga autoritetet vendase, një numër pyetjesh të hapura mund të jenë të mjaftueshme për të përcaktuar nevojat gjuhësore të të pandehurit. GJEDNJ-ja ka vënë theksin në rëndësinë e shënimit në procesverbal të çdo procedure të përdorur dhe vendimi të marrë në lidhje me verifikimin e nevojave për përkthim, çdo njoftimi të së drejtës për një përkthyes dhe çdo ndihmë të dhënë nga përkthyesi, siç është përkthimi me gojë ose përmbledhja me gojë e dokumenteve, në mënyrë që të shmanget çdo dyshim në këtë drejtim që mund të ngrihet më vonë gjatë procedurave<sup>7</sup>.

### III. Vlerësimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit

<sup>4</sup> Hermi kundër Italisë [GC], nr.18114/02, 18 tetor 2006

<sup>5</sup> Baytar kundër Turqisë nr. 45440/04, § 50, 14 tetor 2014;  
Diallo kundër Suedisë, nr. 13205/07, § 25, 5 janar 2010

<sup>6</sup> Brozicek kundër Italisë, nr. 10964/84, § 41, 19 dhjetor 1989;  
Kamasinski kundër Austrisë, nr. 9783/82, § 79, 19 dhjetor 1989

<sup>7</sup> Vizgirda kundër Sllovenisë, nr. 59868/08, §§ 84, 85, 28 gusht 2018

Avokati i Popullit vlerëson se përkthyesi sipas ligjit procedural penal është një nga pjesëmarrësit e procedimit penal, cilësi që e mbart vetëm një person që ka njohuri të posaçme, i vërtetuar ky fakt nga organi kompetent, Ministria e Drejtësisë.

Personi që është përkthyes zyrtar i miratuar nga Ministria e Drejtësisë, është një person i aftë për të kuptuar e vlerësuar nëse komunikimi në gjuhën ku ai është certifikuar si përkthyes është “i mirë, shumë i mirë ose mjaft i mirë etj”. Figura e tij është shumë e rëndësishme duke qenë se ligji procedural penal parashikon përgjegjësinë dhe detyrimin e përkthyesit për të bërë një përkthim të saktë (nenet 123 - 127 të KPP-së).

Sikurse e përmendëm më lart, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton njoftimin e kujtdo të cilit i hiqet liria, në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Parashikon të drejtat kushtetuese të individit në një proces penal, mes të cilave edhe të drejtën për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe.

Në rekomandimet e tij, Avokati i Popullit ka theksuar se në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, liria personale nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

Në këndvështrimin tonë, dispozitat e mësipërme kushtetuese janë në përputhje me parashikimet e KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kjo e fundit lidhur me të drejtën e të pandehurit për t’u njohur me akuzën dhe aktet në një gjuhë që ai kupton, ka theksuar se është detyrë e autoriteteve vendase të verifikojnë nëse i pandehuri kupton gjuhën e gjykatës ose gjuhën e akteve, duke referuar për këtë vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Brozicek kundër Italisë dhe Kamisinski kundër Austrisë.

Dispozitat kushtetuese kërkojnë që njoftimin e personit që i është hequr liria të realizohet në gjuhën që ai kupton për shkaqet e masës dhe akuzën që i bëhet atij. Në zbatim të normave kushtetuese dispozitat procedurale penale kanë përcaktuar rregullat e zbatueshme gjatë procedimit penal, **përfshirë caktimin e përkthyesit**, si një nga pjesëmarrësit e procedimit penal, për qëllimet e mësipërme.

Paragrafi 3 (e) i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se çdo i pandehur ka të drejtën e ndihmës falas nga një përkthyes. Kjo e drejtë zbatohet jo vetëm për deklaratat me gojë të bëra në seancën gjyqësore, por edhe për materialin dokumentar dhe procedurat paragjyqësore.

Një i akuzuar që nuk mund ta kuptojë ose ta flasë gjuhën e përdorur në gjykatë, pra, ka të drejtë për ndihmën falas të një përkthyesi për përkthimin ose interpretimin e të gjitha atyre dokumenteve ose deklaratave në procedurat e ngritura kundër tij, të cilat është e nevojshme që ai t'i kuptojë ose që t'i ketë përkthyer në gjuhën që përdoret në gjykatë në mënyrë që të përfitojë një gjykim të drejtë.

Megjithatë, mbetet fakti se ndihma e ofruar për përkthim duhet të jetë e tillë që t'i mundësojë të pandehurit të ketë njohuri për çështjen kundër tij dhe të mbrohet, veçanërisht të jetë në gjendje të paraqesë para gjykatës versionin e tij të ngjarjeve. Gjykata vëren në këtë drejtim se detyrimi i autoriteteve kompetente nuk kufizohet vetëm në caktimin e një përkthyesi, por, në rrethana të veçanta, mund të shtrihet edhe në një shkallë kontrolli të mëvonshëm mbi mjaftueshmërinë e përkthimit.

Sa rezulton pra, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve të përfshira në procedura, në veçanti e gjykatave vendase, të caktojnë gjatë gjykimit një përkthyes për të ndihmuar të pandehurin.

Avokati i Popullit konstaton se duke pasur parasysh vendin që zë në një shoqëri demokratike e drejta për një proces të rregullt ligjor, mund të vihet në pikëpyetje sa herë që ka arsye për të dyshuar se i pandehuri nuk është mjaftueshëm i aftë në gjuhën e procedurave, për shembull nëse ai ose ajo nuk është as shtetas dhe as banor i vendit në të cilin po zhvillohen procedurat.

Sigurimi i përkthyesit në procesin penal është detyrim i shtetit shqiptar, i cili duhet të garantojë paraqitjen e tij dhe respektimin e kësaj të drejte për shtetasit e huaj që procedohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në rastin konkret të shtetasve rumunë, duke konstatuar se nga gjyqtaret janë bërë përpjekjet e nevojshme për sigurimin e paraqitjes së përkthyesve në këtë çështje, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të marrë masa për miratimin e një udhëzimi për garantimin e kësaj të drejte dhe unifikimin e praktikës në të gjitha gjykatat e vendit. Gjithashtu, bashkëpunimi

i KLGJ-së me Ministrinë e Drejtësisë është shumë i rëndësishëm, për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe ato të brendshme.

Avokati i Popullit sugjeron se në kuadër të ndryshimeve që po bëhen në fushën penale, në kodet përkatëse, është e nevojshme të shihet si mundësi edhe përfshirja e teknologjisë së informacionit për realizimin e përkthimeve gjatë proceseve gjyqësore.

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) është i përfshirë në mënyrë aktive në forcimin e aftësive të teknologjisë së informacionit (IT) dhe dixhitalizimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri, veçanërisht përmes iniciativave si projekti Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ). Gjithashtu, CEPEJ në vijëmbësi bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për të zhvilluar kurrikula trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët mbi aftësitë dixhitale dhe përdorimin e Inteligjencës Artificiale, duke i përafruar këto përpjekje me zbatimin e një sistemi të ri elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe respektimin e standardeve evropiane për drejtësinë kibernetike.

Avokati i Popullit çmon, se nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për të siguruar përkthimin gjatë proceseve gjyqësore, atëherë gjykatat duhet t'i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e hetimit disiplinor të përkthyesve që nuk paraqiten në seancat gjyqësore, pa shkaqe të arsyeshme dhe në mënyrë të përsëritur, në zbatim të nenit 9 të VKM nr. 407, datë 05.07.2023 *“Për përcaktimin e kriterëve e të rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë”*.

Ministria e Drejtësisë konfirmon me shkresën nr.M-304/1 prot., datë 10.10.2024 se përkthyesit zyrtarë nuk pranojnë të marrin pjesë në procese gjyqësore, për më tepër nga një qytet në tjetrin, për shkak të pagesës së ulët.

Ndaj, Avokati i Popullit vlerëson se Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 19.07.2022 *“Për përcaktimin e tarifave dhe për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”* dhe udhëzimi nr.4, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave *“Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*, duhet të rishikohen në kuadër të përcaktimit të pagesave të

përshtatshme në përputhje me shërbimin që ofrojnë përkthyesit gjatë procesit gjyqësor, shoqëruar edhe me shpenzimet përkatëse, parë kjo në frymën e Kushtetutës dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.

Sa më sipër, ndërkohë që përmbajtja e vendimeve gjyqësore nuk është në kompetencë të Avokatit të Popullit, administrimi i përgjithshëm i çështjeve hyn në kompetencën lëndore të Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, si dhe Parimet e Komisionit të Venecias për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut të vitit 2019<sup>8</sup>.

Sipas këtyre parimeve Avokatit të Popullit i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Edhe vetë Komisioni i Venecias, duke njohur dhe pranuar parimet themelore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut të tilla si pavarësia, objektiviteti, transparenca, drejtësia, paanshmëria si dhe duke e konsideruar se këto institucione janë një element i rëndësishëm në një shtet të bazuar në demokraci, sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe qeverisje të mirë ka miratuar parimet mbi mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.

Në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve* më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, në ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/b, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, dhe në nenin 21/c, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen,*

### **REKOMANDOJMË:**

---

<sup>8</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2019)005-e)

1. Marrjen e masave nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për hartimin e një udhëzimi lidhur me procedurën e caktimit të përkthyesve nga gjykata dhe unifikimin e praktikës së caktimit të tyre në rast mosparaqitjeje.
2. Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet KLGJ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë për rishikimin dhe forcimin e rregullave të caktimit të përkthyesve në proceset gjyqësore penale, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në nenin 15/2 të Kushtetutës.
3. Marrjen e masave nga Ministria e Drejtësisë për rishikimin e udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 19.07.2022 *“Për përcaktimin e tarifave dhe për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike”* dhe Udhëzimit nr.4, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave *“Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”*, me qëllim përcaktimin dhe realizimin e pagesave dhe shpenzimeve të përshtatshme për përkthyesit gjatë procesit gjyqësor.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**

D.V